KADRI ALIT SHERIFI

ZËRA SHPIRTI

U nisëm për udhë të heshtur si gur,

fytyrë e tim eti seç qeshte me nur,

diku u ndanë udhët, e u falëm tok,

hodha supit strajcën ngarkuar me lot...

POEZI

Zëra Shpirti

poezi

2010

Autori:

Kadri A. Sherifi

Redaktor:

Lebit Murtishi

Lektor:

Zekë Krasniqi

Recensent:

Lebit Murtishi

Kopertina:

Vjola Sherifi

Tirazhi: 1000 copë

Shtypur në shtypshkronjën >>Tringa Design<<

Tetovë 2010

Zëra Shpirti

poezi

Kadri Alit Sherifi

Zgjodhi e përgatiti për shtyp:

Lebit Murtishi

Në vend të parathënies

-Vëlla Kadri:

-Të falenderoj me gjithë qënien time, që mua ma besove këtë punë kaq të brishtë dhe të përgjegjëshme njëkohësisht. Të falenderoj që më zgjodhe mua të përgatis për shtyp këtë kurorë vargjesh shpirti, që pasqyrojnë dhimbjen dhe brengën e shpirtit tënd të madh...

-Ti nuk përdor, siç bëjnë të tjerët, stoli zambakësh a fletë jargavanësh për të ndryshuar faqen e jashtme të vargut tënd. Sikur s`të shkon stoli e rrejshme, sikur s`e do fjalën e zbrazët. Ti për stoli ke zgjedhur shpirtin, ke zgjedhur zambakët e dhimbjeve të tua, ke zgjedhur shpirtin e çiltër që vuan e fal, që s`di të mallkojë; ke zgjedhur shpirtin që rron për të tjerë...

Dhe kjo të mjafton, mjafton që në çdo varg, mjafton që në çdo strofë, qënia jote qan e qesh; ndonjëherë qesh kur i qahet, ndonjëherë qan kur i qeshet. Më duket se ti, me atë urtësinë tënde të pazakontë, herë veten kërkon tek shumësi, e herë shumësin brenda vetes. Vargjet e shkëputur:

O njeri ti qënie e përsosur,

ktheju vetes n'dashuri,

flasin çuditërisht për një gjetje personale komunikimi. Kur ti flet me njeriun, flet me veten tënde, por flet njëkohshëm edhe me shumësin, sepse njeriu në vargun tënd përfaqëson njerëzimin, përfaqëson shumësin.

Megjithë të metat që gjen me të drejtë tek njeriu i sotem, ti, gjithashtu me të drejtë, e quan të përsosur.

Vet vlerësimi aq dashamirës që i bëhet njeriut, dëshmon dashurinë tënde të pafundtë që ke për njeriun si qënie më e dashur e Krijuesit.

-Herë bëhesh njëjës e kritikon veset e shëmtuara të shoqërisë moderne, e herë bëhesh shumës e thërret

për paqe, ashtu siç thërret shumësi gjithmonë. Vargu në vijim thotë:

„Dua të të marr në perqafim''

Kur dihet se rrugë e jetës është e gjatë dhe e mundimshe, kur dihet se rrugë e jetës kërkon bashkim, ti merr rrolin e shumicës, ti flet me zërin e tyre.

-Fjalët: Zot, njeri, paqe, motër, vëlla. Mik etj... nuk janë veç fjalë të tua, ato janë univerzale, janë fjalë të shumësit, me gojën e të cilit ti i drejtohesh, herë vetes dhe herë të tjerëve. Kur kthehesh në vendlindjen tënde të largët, ti jo vetëm që shpreh mallin e pashuar për Çegranin tënd, por shpreh dhe krenarinë për historitë e tij, shpreh dhe entuziazmin për dheun e lindjes. Vargjet:

s`di t`i shkruaj të gjitha këngët,

për shekujt që yjtë t`i vranë...

flasin shumë më tepër seç mund të shkruaj unë mbi këtë letër, flasin shumë më tepër nga heshtja yte e zhurmët...

-Jeta nuk të kurseu, por ti, edhe i zhytur gjer poshtë dhimbjeve të saj, edhe i shkelur sa e sa herë nga djallëzitë e saj, përsëri klith për paqe; i thua vëlla, i thua mik, të gjithë atyre, që unë nuk e di a e meritojnë.

Unë, duke i thyer rregullat e pashkruara të një kritike letrare, më shumë po flas me ty se sa për veprën që doli në dritë. Ky është një përjashtim tepër i natyrshëm, ngaqë të njoh siç njoh vetveten, ngaqë më njeh siç njeh vetveten...

Të njoh, dhe e di, se përpara se të betohesh në Zot për të mbetur njeri, ke qenë vet simbol i këtij betimi, ke qenë personifikim i asaj qënie, që ti ke zgjedhur si lajtmotiv për të komunikuar me rrethin e gjërë, dhe për të lutur edhe të tjerët, që përpara se të jenë të bardhë a të zinjë, përpara se të jenë të këtij apo atij besimi, të jenë njerëz, të jenë njerëz...

-Shpirti yt është gjuha e vetme poetike, është arma e vetme që ti përdor për të zbutur shpirtërat e egërsuar, për të zbutur qëniet, që ti i quan të përsosura.

Të gjithë të Zotit jemi,

Të gjithë të njejtë jemi...

-Nuk do të them se i ngjan këtij apo atij rilindasi, më mirë ngjaji vetvetes, kjo të mjafton, kjo të mjafton... Kur kujton Atdheun e lashtë, i gjen edhe trazimet e shpirtit në çdo pjesë të copëtuar të tij...

"Shqipëri nën`e trazuar"...

çdo kërkonte më shumë ky varg për të pasqyruar plagët e Atdheut. Ty të dhemb zvetënimi i shoqërisë, të dhemb degradimi i saj, por kurrë s`bie në pesimizëm. Përherë thua:

"O njeri qënie e përsosur

Ktheju vetes n`dashuri"...

-Uroj që të vazhdojsh të shkruajshë, po kaq urtësisht, po kaq çiltërsisht, pa drojë e pa dorëza...

Lebit Murtishi

10.04.2010

Bern

Një rreze

Në rrugët e botës
shtegtoj...
si zog i pa cak
i pa anë,

Kujtoj dashuritë që ikën
si ëndërr e ankthtë e trishtë,
dhe fiket një yll brenda meje,
siç fiket një rreze e brishtë.

12.03.2006 Neuhausen

Dua…

Dua të marr ndonjë drejtim,
e të mos kthehem prap,
s`dua të ndal as për pushim,
dua të ik me vrap...

Dua të marr ndonjë drejtim,
i heshtur e pa fjalë,
mbase njerëzoren gjej diku,
si diogjeni i marrë....

21.04.2007 Neuhausen

Bilbilit

Shoh bilbilin majë pemës,
ia thotë këngës degë më degë,
i zgjedh vargjet brenda zemrës,
si i dehuri boem.

Dehet tej në degë bilbili,
si boem i vrarë në shpirt,
s`di se ç`kam tek shoh bilbilin
më lotojnë padashur sytë...

Pa mbaruar mirë fjalinë,
një zë pushke kris nga lartë,
u përplas bilbili i lirë
krahëhapur në livadh.

27.09.2006 Neuhausen

Vdekja e tim eti

Atë ditë priste një udhë dikund,
një ëndërr e vrarë pa fill e pa fund,
më priste gurbeti tej në arrati,
dhe nata zvarritej gjer në pakufi...

Më zvarritej dhimbja shpirtit si rrëke,
zhurmonte një ndjenjë s`më linte të fle,
po nisej për udhë shpirti i tim et,
e gjëmonte kënga, ah gurbet i shkretë...

U nisëm për udhë të heshtur si gur,
fytyrë e tim eti seç qeshte me nur,
diku u ndanë udhët, e u falëm tok,
hodha supit strajcën ngarkuar me lot...

24.01.2007 Neuhausen

Vdekja e nënës

Tek sa rrudhat n`dorë numëroja,
tek më shihte me shumë mallë,
tek kërkonte buzëqeshjet,
tek kërkonte lot` e fjalë,
n`rrudha t`ballit diku fshehur
shfaqej nur i shpirtit t`saj.

Për shtat` ditë e për shtat` netë,
tek po priste dergj` e shkretë,
t`mirrte udhë qiellit lehtë
Shpirti saj me dy palë fletë,
seç i ndjeva tek më thyhen
brenda shpirtit buzëqeshjet.

02.05.2010 Neuhausen

Çegranit tim

Nën malin e thatë ke rrënjët,
e plisin e bardhë mënjanë,
nuk di t`i shkruaj gjithë këngët,
për shekujt që yjet t`i vranë.

Një ditë nëntori u linda,
nën rrezen e dritës së ngrohtë,
dhe frymën e parë e thitha,
tek frynte furtunë dhe llohë….

Çegran o vendi i lindjes,
pak stinë më fale për mall,
e rrallë të pashë ndër vite,
o ëndërr e mbushur me zjarr...

Çegran o gjëmë historie,
o vatër ilire e gjallë,
ti shtrove në sofër Kosovën,
kur zjarret mbi kulla i ranë…

i shtrove me bukë e me kripë,
siç pritet në sofër vëllai,
i fale barut e fishekë,
tek hidhej si motesh mbi shkaun.

26.06.2006 Neuhausen

„Shtatorja e Skënderbeut“

Mirë se na gjete
i madhi Skënder-be,
nderove konakun,
nderove këtë Dhé.

Qëndro kryelartë,
je në vendin tënd,
nëse duhet biem
sërish dhëmb për dhëmb.

29.11.2006 Neuhausen

Mos u zemro...

Mos u zemro, që s`je sot pranë meje,
mos u zemro, që nesër s`do të jesh,
mos u zemro, që s`ishe as dje,
por edhe mos qaj,
mos qaj pra,
por qesh.

Mos u zemro, që sot pranë s`të kam,
mos u zemro, se
unë vetë nuk jam.
Ato pak kujtime,
që i mblodha n`jetë,
tash më shoqërojnë,
dhe s më lënë t`jem vetë.

13.04.2007 Neuhausen

Atë vend me pluhur...

Atë vend me pluhur ëndërroj përnatë,
se atje më treti ëndërr e fëminisë,
shtrohej sofër e varfër: bukë, kripë e dhalltë,
po ishte e bollshme ndjenj` e dashurisë.

Po pse një grusht pluhur s`e mora me vete,
pyes në pasqyrë një fytyrë meiti,
ta mbaja të fshehur udhëve të botës,
si trofe të mbetur nga një dhimbje shpirti...

09.03.2007 Neuhausen

Shpirti i vrarë

Çdo gjë të bukur e dua,
siç dua dhe jetën paanë,
por rob t`i bëhem nuk dua,
as shpirtit që tinëz ma vranë...

17.02.2007 Neuhausen

Kod` i jetës

Të rritesh i lirë,
si zogu or bir,
e kurrë mos të shtertë
djersa mbi fytyrë...

14.02.2007 Neuhausen

Hipokrizi...

Një fytyrë ka i miri,
dhe i poshtri një fytyrë,
siç u ka pëlqyer vetja,
shfaqen sheshas në pasqyrë.

Po askush një herë s`e dijti
ç`mbulon maskë e hipokritit...

30.01.2007 Neuhausen

Edhe njëherë si dikur...

Eh! ç`do kisha dashur të kthehem dhe njëherë,
rreth asaj tryeze me pemë e perime,
të gjëmojë kënga e le të më dehë,
këngë e përgjëruar, këngë e rinisë sime...

Eh! ç`do kisha dashur së toku dhe njëherë,
me miqë e me shokë këngët t`i këndojmë,
këngët që ndër shekuj shqip ia than përherë,
këngët që njeh shpirti, këngët që mungojnë.

Kam mbetur i vetëm me fotografitë,
tavolinë e vjetër seç thotë në heshtje,
dhe në heshtje lotët përvëlojnë sytë,
dhe këngët e mia ulërijnë në heshtje...

25.01.2007 Neuhausen

Lot i syrit

Kur syri loton,
e loti rjedh ngadalë,
në faqen e brishtë
lë gjurmë e zjarrë.

O zjarr i shpirtit tim,
qelibar që je,
po a nuk më thua;
gurrën ku e ke?!

Anëve të dhimbjes,
i fshehur ri unë,
jam mik i përhershëm,
në syt` e pagjumë.

02.04.2006 Neuhausen

Pagjumësia

Nuk kanë më paqe sytë e mi,
nuk kanë më gjumë si dikur,
më pengon dhe këngë e orës,
tek ja thot` me takt mbi mur...

24.01.2007 Neuhausen

Çudia njerëzore

Ç`malukat nuk ka kjo botë,
s`dijnë nga vijnë e nga shkojnë,
s`besojnë fe s`besojnë Zot,
duken soj po janë demonë...

22.01.2007 Neuhausen

Ç`do gjë është e kotë

Mos e qani shokë, kohën që kaloi,
se janë dhjetëra shekuj s`dini ku filloni!
s`dini ku filloni sdini ku mbaroni,
ndonjë e harroni e mund ta lëndoni.

Mos qani me lotë as me ngashërim,
se mbase do Zoti na fal një bekim,
një bekim të vetëm Zoti madh në dashtë,
të na pushojnë eshtrat në dheun e lashtë...

13.01.2007 Neuhausen

Shokut tim…

Nga rrëketë e shpirtit tim
zgjodha fjalën më të bukur,
t`i shkruaj shokut nji kujtim,
se kur vuan është i lumtur...

Isha unë që e mendova,
isha unë që e shkrova,
isha unë që e lexova,
me të qarë e durova....

“Udhë e dhimbjeve të gjata
është nder o miku im,
ndaj jeto nëpër shtërngata
e gjeç paqe në amshim”

18.03.2010 Neuhausen

Dialog me veten

U mendova gjatë,
të flas me veten thashë,
ti bëj nja dy fjalë,
të dalë ku të dalë...

Dhe hop u pengova,
që në hap të parë,
s`gjeta paq` me veten
he dreqi ta marrë....

07.01.2007 Neuhausen

Labirinth...

E kërkon e s`e gjen dot,
se ku t`ik e s`e arrin,
e kërkove dje dhe sot
sikur mori arratinë.

Mos u lodh se s`e gjen dot,
mos u sill më kot vërdallë,
kur ke humbur brenda vetes,
s`ke ç`kërkon nëpër mëhallë....

03.01.2007 Neuhausen

Në lëmshin e kohës

Po të kem forcën e durimit,
e të futem në lëmshin tënd,
do ta gjej fundin e fillimit
tek rri mbështetur në ndonjë kënd.

Dhe pastaj lëmshin ta marr në dorë,
dhe të gjej fillin ku fle pastaj,
të zgjidh çdo nyje lidhur më parë,
të shoh se derrit s`i thuhet dajë.

02.01.2007 Neuhausen

Kënga e heshtjes

Ti prite nga unë të them ndonjë fjalë,
të them fjalë koti apo një të rrallë,
u solle rreth meje e heshtur ngadalë,
dhe dole si hije m`u ndale përballë.

Dhe prisje një fjalë nga malli i parë,
nga malli i mbetur që djeg si një valë,
po ti u zhgënjeve o ëndërr e marrë,
se heshtja përpinte çdo këngë, çdo fjalë…

Sa vite të zgjatur kjo heshtje më ndjek,
kjo këngë e përmorttë që paqen ma vret,
dhe desha ta flakja tej në ndonjë breg,
por pashë që heshtja kisha qenë unë vet...

20.12.2006 Neuhausen

Më thuaj...

Më thuaj ku është trëndafili,
më thuaj pse pemët s`kanë hije,
më thuaj pse s`çelin qershitë,
më thuaj pse buzët s`kanë shije?

Më thuaj e ç`mendura kohë,
nga iku rinia e marrë,
më thuaj pse bluaj në kokë,
mendime e ëndrra me zjarrë....

07.01.2007 Neuhausen

Vajza e ambël - (Amblës)

Kur ecje në rrugë,
dhe në kopësht shkoje
çdo kend me të qeshur
t`përshëndesësh doje.

Buzëqeshja jote,
më bënte të mendoj
sa mund t`jet e ambël?
e s`mund ta provoj!.

Një ditë e kuptova,
emrin tënd t`vërtetë,
ti ishe vet` Ambla,
e gëzofsh për jetë.

10.12.2006 Neuhausen

Liria ime

E dua lirinë,
më shumë se ç`më do,
herë ajo është unë,
herë unë jam ajo.

E dua tek tjetri,
po kurrë s`e marr,
ashtu si tek vetja,
që kurrë s`e fal…

10.12.2006 Neuhausen

Gjumi - (Vjolës)

Në gjum` o xhan, në gjum` o shpirt,
e rritmu shpejt për natë për ditë,
e ndiqe dritën ëndrrash paanë,
e ndiqe dritën shpirtit që mban...

Në gjum` o xhan, në gjum` o shpirt,
ëngjull` i ëndrrës ty të bën dritë,
mos e bë jetën ëndërr o shpirt,
por ëndrrës jepi jetë përditë...

05.12.2006 Neuhausen

Nëntori

Nëntor…
o muaj shqiptar,
nëntor i bekuar ti mbeç,
dhe bota kur udhën do marrë,
ti gjallë dhe pas botës do jesh…
ditët me gjak t`i kanë larë,
netët me zjarre t`i dogjën,
ndaj mbete legjendë e paanë,
se namin as vdekjet s`ta hoqën…
të paçim për mot e për jetë,
nëntor i përshkuar në zjarr,
dhe ditë marrç nga të miat,
ti nur i flamurit shqiptar…

28.11.2006 Neuhausen

E di mirë s`e diku pret

E di mirë se të lash vetë,
jo se s`desha tët` kem pranë,
porse rruga ish e gjatë,
mos më lodhesh kisha hallë...

27.11.2006 Neuhausen

Rrugë

Nëse vjen me mua,
mos pyet ku shkoj,
ndiqe hapin tim,
dhe hesht kur gjëmoj.

Mos hec prapa meje,
as para mos më dil,
në një hap të ecim,
deri në amshim.

Nëse vjen pas meje,
mos pyet ku shkoj,
ndiqe këngën time,
dhe qa kur këndoj.

26.11.2006 Neuhausen

Vetëm një dëshirë

Sa dëshira kisha as vetë nuk e di,
Se, sa herë mendoja shtohej edhe nji.

Kam dëgjuar t`thonë: „jeto në këtˋ botë“,
Por jeta me ëndrra na qenka e kotë.

Dëshirat më nj`anë, punës jepi vlerë,
Që të kesh respekt dhe t`jetosh me nderë.

Unë në këtë botë, për një jetë të mirë,
Veç punës dhe nderës, kam dhe një dëshirë.

Tash i lutem Zotit „Zot më bëj dhe mua
siçˋ i do Ti njerëzit edhe unë t`i dua“.

22.11.2006 Neuhausen

Civilizimi

Civilizim, civilizim,
ti reklamë e pabrekë,
gjithë rininë ke hutuar
dhe të vjetrit pret në shteg.

Civilizim i çudive,
lakuriq në katër anë,
jetojmë kohën e kurvnive,
kujdes se mos gjejmë belanë.

Plis të bardhë mbajnë veç pleqtë,
kështu kanë qenë që më parë,
tani heqin edhe brekët,
modë e re dreqi ta marrë.

20.11.2006 Neuhausen

Këndo një këngë

Çkado që të ndodh me mua,
të lutem bëj durim,
mos kërko fajtor për mua,
se faji ësht` jetim.

09.06.2007 Neuhausen

Malësorja e Sharrit

Oj malësore e malit Sharr,
s`të ka mbetur gjë pa parë,
më trego pash Perëndinë,
si ta qajmë sot lirinë?!

Po dëshmorët që kan rënë!
ç`amanet moj të kan lënë!
a mos vallë të kan thënë!
a mos vallë në gojë kanë zënë!

S`duam valle e ahengje,
s`duam gurë e lapidarë ,
veç të qetë nën Dhé na lini,
mos na vrisni dhe nën varr.

30.10.2006 Neuhausen

Instikti

Ndiqe!.. dhe pas unë i shkova,
që rrugë më rrugë ta ndjek,
me ndjenjën e shpirtit kërkova,
një zemër me zemër të prek.

18. 01.2009 Tetovë

Nganjëherë!

Nganjëherë e dua veten,
nganjëherë e marr inat,
nganjëherë i flas pas shpine,
nganjëherë s`e lë rehat.

21.06.2008 Neuhausen

E qeshur e thyer

Zemër e thyer s`di sa herë,
zemër e mbushur me plot vrerë,
zemër e etur, zemër e vrarë,
zemër e mbushur me mall e zjarr.

Qeshu oj zemër, zemër e thyer,
qeshu që t`mundesh sërish të qashë,
qeshu me zërin tënd të përkryer,
qeshu siç` qeshje edhe më parë.

Qeshu oj zemër se kam një mall…

06.10.2006 Neuhausen

Kur ti flet

Kur ti flet, dua të dëgjoj,
kur ti flet sytë më mbushen plot,
veç prej teje mundem të kërkoj,
dashurinë e ngrohtë që më mungon sot.

Kur ti flet dua të të shoh,
jo n`imagjinatë, po në gjirin tim,
ta shoh at` fytyrë se si duket sot,
ta shoh at imazh që do shpirti im.

12.06.2007 Neuhausen

Ndoshta…

Ndoshta sipas ligjesh
duhet t`thëras tellall,
që t`i tregoj botës
se paskam një hall!

Bota para meje,
çdo detaj di mirë,
prandaj para botës
kam ndjenjën e dlirë.

01.11.2006 Neuhausen

Kujt i duhem

Kujt i duhem unë sot,
kur fuqia më ka lënë,
përveç gruas që më thotë:
pa ty, jetë unë nuk kam.

Po kush tjetër ka nevojë,
të më dojë kështu siç jam,
kur ska si t`më shfrytëzojë,
se fuqi më unë s`kam...

Po i duhem vetes sime,
dhe atyre që i kam xhan,
mbi të gjitha i duhem Vjolës,
që me Shpirt në jet` më mban.

09.06.2007 Neuhausen

Sot e njëqindvjet

Është turp të them: dola në gurbet,
pas më erdhi gruaja, të mos rrija vetë,
morëm dhe fëmijët, në vendin e shkretë,
diku lamë kujtimet diku shpirtin vet.

I huaj kur erdha dhe i tillë kam mbetë,
nuk dot` jem unë ndryshe, sot e njëqindvjet,
nuk kam ëndërruar të jetoj si mbret,
po as pleqërinë të më shkoj e shkretë.

09.01.2007 Neuhausen

Pa titull

Se ç`mund të mendoni nuk e di,
por edhe ta di nuk dua,
mendimin e lirë e ka çdo njeri,
ashtu siç` e kam edhe unë për mua.

Edhe po mendove se qenkam i keq,
a qenkam njeri, a qenkam një „dreq“,
mos u ndal me kaq, jepi dhe më zi,
mendimin e lirë e ke edhe ti.

18.11.2006 Neuhausen

Të qesh a të qajë

A duhet të qesh kur ti nis e qan,
apo kur ti qesh unë duhet të qaj,
a të qaj dhe unë pse ti nis e qan,
apo kur ti hesht, të qesh e të qaj.

16.11.2006 Neuhausen

E drejta ime

Mos ma merr të drejtën që të them një fjalë,
Mos ma merr të drejtën të punoj si kal.

Mos ma merr të drejtën t`mendoj si budallë,
Mos ma merr të drejtën të të puth në ballë.

Mos ma merr të drejtën që të ndjehem mirë,
Mos ma merr të drejtën ta shijoj lirinë.

Mos ma merr të drejtën t`jetoj jetën time,
Mos ma merr të drejtën të bëj dhe gabime.

31.10.2006 Neuhausen

„I marri”

Ki kujdes ti o njeri,
me të marrë mos u shty,
po u ndeshe veç një herë,
për të dalë nuk gjen më derë,

kurrë! i marri nuk dorëzohet,
në çdo vend thotë jam i parë,
dhe kushdo që shok i bëhet,
nga i marri ësht` më i marrë.

09.09.2006 Neuhausen

Ligji i Perëndisë

Shumica mendojnë:
luftë qenka jeta,
ajo është një lojë,
me ligjet e veta.

Që s`ke njohuri
mbi ligjin hyjnor,
s`i ka fajet jeta,
je ti vet fajtor.

Ligjin tre sektorësh
ndau Perëndia,
nëndija, vetëdija
edhe mbivetëdija.

06.09.2006 Neuhausen

Monolog i kohës

I thotë burri gruas:
ku je nisur grua!
shiko punën tënde,
është punë për mua!!!

Gruaja ngre zërin,
gjer lartë mbi re,
është kohë e djalltë,
është modë e re.

04.09.2006 Neuhausen

Mund

Ësht` një mund vet qënja jote,
dikush kot në bot` s`të solli,
që je pjesë e kësaj bote,
dikush farën tënde mbolli.

Do ta thot` edhe përtaci,
çdo lëvizje kërkon mund,
është kërkesë e jetës sate
nga fillimi - gjer në fund.

24.08.2006 Neuhausen

Rrënjët e kombit

O shqiptar! Kudo që je,
mbaji rrënjët që i ke,
mos sharto mbi trung të vjetër,
ndonjë syth të sojit tjetër!

14.08.2006 Neuhausen

U pafshim për të mirë

S`dua të paragjykoj,
aq më pak të akuzoj,
një mendim të them unë dua,
ç`ndodh me ty e ç`ndodh me mua...

Kur gëzim ke ne shtepi,
ke tryezen plot e plot,
ke dhe miq e dashamirë,
keshtu ka qenë që sot e mot...

As te unë s`kan` munguar
gjersa xhepat ishin mirë
kur kjo gjendje u ndryshua,
ikën e s`thanë lamtumirë...

23.06.2006 Neuhausen

A je gjallë

Merr dikush në telefon,
pyet a jam gjallë!..
nuk e sheh ne ç`numër pyet,
tjetrin s`ia kam dhënë…

22.06.2006 Neuhausen

Monotonia

edhe sot,
edhe dje,
brenda vetes,
s`di kush je…

21.06.2006 Neuhausen

Të lutem

Mos eja mbi varrin tim
falje të kërkosh,
mos eja mbi varrin tim
gabime të kujtosh...

Të lutem, mos eja
veten ta mallkosh,
të lutem, mos eja
dheun t`ma rëndosh...

Por nëse të duhet
andej të kalojshë,
një “selam” të gjithëve,
të lutem t`na lëshojshë.

20.06.2006 Neuhausen

Kalimtar i rastir

Kalimtar i rastit,
është në histori,
kalimtar i rastit
është në poezi,
kalimtar i rastit
isha si i ri,
kalimtar i rastit
edhe n`pleqëri.

Nga kjo botë në tjetrën
do` jem përsëri,
kalimtar i rastit
siç është çdo njeri.

19.06.2006 Neuhausen

Oda e burrave

Nëpër oda burrash
gatuhej trimnia,
me besën shqiptare
shkruhej historia.
Në odën e miqëve,
kafe e duhan,
me kokra baroti
shkruhej fjal` e dhënë.
Edhe sot ka burra
që na kuvendojnë,
me kupa rakie
bëmat numërojne,
po tek kupë e fundit
se kush janë harrojnë.

18.06.2006 Neuhausen

„Sedra”

Ikën me ngadalë vitet e rinisë,
u bëra dhe plak falë perëndisë,
po ti „sedërzeza” ç`paske qenë besnike,
që më ndoqe pas ndër gjith` këto vite.
kur unë isha vetë dhe s`kisha askend,
as ti „sedërzeza” s`më shkonje ndërmend,
nga dera e madhe kur dëgjoja zilen,
ma mësoje stilin me njerëz si t`sillem,
edhe n`tavolinë kur rrinja me shokë,
më dilje përpara e m`hypje mbi kokë,
kur ngreja dolli un` për ndonjë tjetër,
sërish ajo këng` dhe melodi e vjetër
si duket çdo lodhje paska qenë e kotë,
mbase do më ndjekësh edhe në at` botë!

17.06.2006 Neuhausen

I ligu

Kur mungon buka në sofër,
ndihmë Zotit i kërkojmë,
kur një ditë tepër kemi,
harrojmë Zotin ta kujtojmë!

17.06.2006 Neuhausen

Të thënat

më thanë kështu...
më thanë ashtu...

nuk mbeti gjë
pa më thënë.

i thashë kështu...
i thashë ashtu...

krejt çka deshta
ia kam thënë.

Ç`më ke thënë e ç`të kam thënë,
Janë të thënat që janë thënë!!!

05.06.2006 Neuhausen

Pa-kujdesia!

Ndodhë natyra të hakmeret,
për veprimin tonë të marrë,
dhe i fundit lum të shterret,
prap s`mendojmë ku do dalë.

Ç`do ta mbushë sofrën tonë!
këtë duhet ta kujtojmë,
leku s`qënka për ta ngrënë!
këtë s`duhet ta harojmë.

Peshku s`rritet dot pa ujë!
edhe toka s`bën pa shi,
babë e bir do jenë të huaj,
s`është njeriu më njeri!

05.06.2006 Neuhausen

Jetëkalimi

Rrugë e jetës është e gjatë,
shembuj kemi në çdo anë,
na ndjek hija tej e ndanë,
na ndjek gjurma që e lamë.

03.06.2006 Neuhausen

Vullneti i lirë

Çdo kend dua ta kuptojë,
me të mirat që i ka,
dhe të metat t`ia pranojë,
tjetër kut kjo jetë s`ka...

Në këtˋ botë kështu si jemi,
„Një vullnet të lirë e kemi”.

28.05.2006 Neuhausen

Lules së tharë

Ç`më shkoi mendja për një lule,
jo një lule çfarëdoqoftë,
tek një lule dashurie,
karajfile erë plotë.

N`kopshtin tim të fëminisë,
shkova lulen që ta marrë,
s`duhej shumë të zgjedh se cilën,
m`ikën sytë tek lule tharë.

27.05.2006 Neuhausen

Pasqyr-fytyra

Më pëlqen kështu si jam,
me ketë pamje që e kam,

Thuaj pra pasqyra ime!
e shfaq vërtet fytyrën time?!

Njerëzit s`më pranojnë si jam,
e nuk di se ç`dreqin kanë,

Ndaj të lutem ty, pasqyrë,
ma bëj siç` duan, një fytyrë?!

24.05.2006 Neuhausen

Mall nëne - (Florës)

Ah! se ç`kam një mall,
që s`e shuaj dot,
të të kem përballë, e
t`a mbush zemrën plot.

Ah! se ç`kam një mall,
brenda gjirit tim,
të të puth në ballë,
bir o loti im.

22.05.2006 Neuhausen

Bota e çudirave

Në botën e fëmijëve,
ëndërrat janë të mira,
është një botë e madhe,
botë me shumë çudira.

Sa ishim fëmijë,
qeshnim dhe me lot,
e sot dimë të qajmë,
nganjëherë dhe kot.

22.05.2006 Neuhausen

...kuptim...

Kaloj rrugën!
e dal m`at` anë,
vazhdoj më tej,
një qëllim e kam,
të tjerët vështrojnë,
dhe kalojnë n`kët` anë,
disa s`di ç`mendojnë!
disa zëshëm shajnë!!!

20.05.2006 Neuhausen

Shumë fjalë

Shumë fjalë dua t`i them,
që dikur pathënë i lashë,
të gjithë pranë dua t`i kem,
që t`i shoh, se kurrë s`i pashë.

Dua të them, sa rëndon jeta,
veç e tillë ka kuptim,
padyshim dhemb e vërteta,
e sëmbon si nji mallkim.

Është e bukur tek sa qeshim,
është e bukur tek sa qajmë,
por shëmtinë e ka me vete,
tek sa njëri - tjetrin shajmë.

19.05.2006 Neuhausen

Dituria

Dituria është hyjnore,
është bima më e shtrenjtë,
ësht` bekim që zoti zgjodhi,
për njerinë si të shenjtë.

Lind njeriu i mësuar,
dhe mëson në rrugëtim,
si një trup që s`bën pa hije,
s`bën as mendja pa mësim.

Sot njeriu bën çudira!
e blen dijen me dollarë,
sa më shumë që e paguan,
aq më shumë ësht` për të qarë.

16.05.2006 Neuhausen

Bukuria djallëzore

Për atë që pashë nga jeta
po e lë një porosi,
ç`desha unë, atë e gjeta,
ndaj dhe ç`doni ju, e di.

Doni vashën lozonjare,
të ket pamje engjëllore,
ti ket sytë plot me zjarre,
t`shembëllej në lule bore.

T`jet e hollë dhe truphedhur,
të jet me hire si hyri,
po harroni se vet djalli,
në trup të saj i fshehur rri!!!

14.05.2006 Neuhausen

9 Maji - (Florës)

Ditëlindjen sot ke ti,
sot kjo dit` të takon ty,
i gëzofsh këto pranvera,
paç gëzim dhe n`vite tjera.

Ësht` urimi personal,
dhe fëmijët kanë dëshirë,
t`jetosh n`gjirin familjar,
me at` zemër e shpirt të mirë.

09.05.2006 Neuhausen

Brenga e kohës

Në ballkonin e shtëpisë,
të dy bashkë kuvendojmë,
kujtojm ditët e rinisë,
kujtojmë kohët që gjëmojnë.

Nuk harrohet brengëshkreta,
thell` në shpirt ka zënë vend,
kështu e paska pasur jeta,
ti o Zot na i ruaj mendët.

Ty të falemi me nder,
që na mbron nga çdo e keqe,
vetëm Ti je Një me vlerë,
Ti jep jetë e Ti jep vdekje.

09.05.2006 Neuhausen

Jeta është një harmoni

Nuk jetohet pas konceptit,
që tjerët tregojnë,
qasju pak realitetit,
e dil nga ky hon.

Me të mirën e të keqen,
shko në harmoni,
melodinë po ia gjete,
vallzo gjer n`pleqni...

Çdo njeri është një fletë
e bardhë pa një njollë,
aty pra qëndise jetën ,
ti o mendjeholle...

07.05.2006 Neuhausen

Kufijtë e jetës

Shumë ëndrra jetës rrjedhin,
që s`dimë t`i shpjegojmë,
dhe na duken vetëm trille,
brenda mendjes sonë.

Herë kujtohemi për vete,
herë e lëmë më nj`anë,
herë i falemi k`saj jete,
herë shajmë gjithë dynjanë!?

Duam jetë, dhe liri,
veç të mira prekim,
e harojmë cilës rrugë
gjyshërit ti ndjekim.

04.05.2006 Neuhausen

Rrofshi qofshi sharllatanë

Ca të duan, ca të shajnë,
ca t`këndojnë, ca të qajnë,
ca të nëmin, ca t`bekojnë,
ka dhe ca që s`dinë ç`kërkojnë,
rrofshi qofshi sharllatanë.

Mos i shaj! se janë të gjorë,
të keqen njohin për Zot,
kanë veshë po s`dëgjojnë,
kan dhe sy por s`shohin dot.

04.05.2006 Neuhausen

Sinqeriteti

S`është leht` t`jesh i sinqert,
në këtë botë baltë e llumë,
me që është realitet,
flisni ju më shumë se unë!

04.05.2006 Neuhausen

Pendimi

E kam të dëgjuar,
e them dhe njëherë,
t`bësh vepra të mira,
është gjë me vlerë.

Për ato mëkate,
që thellë u pendove,
Zoti do t`i falë,
mëshirë po i kërkove.

01.05.2006 Neuhausen

Mosha e pleqërisë

Në moshën e pleqërisë,
s`ësht` si n`kohën e rinisë,
n`pleqëri qesh dashuria!
në rini është xhelozia.

Dhe një herë, t`isha i ri,
s`dot` përfillja xhelozi,
le t`më dehte dashuria!
le t`më shante çdo njeri.

Atij, që në pleqëri,
i shkon mëndja n`dashuri!
le ta bëj, e t`i jap zjarrë,
se ajo e mban të gjallë!

30.04.2006 Neuhausen

Fytyrë e dyfishtë

Shumë kujtime hidhen n`letër,
por ka shumë që s`mund t`i hedh,
se mendon që dikush tjetër,
krejtësisht ndryshe mund t`i dredh.

Themi ka armik të tmerrshëm,
që t`vërsulet me yrysh,
s`ësht` çudi ta dijsh për t`ndershëm,
një kodosh a një këlysh...

Nuk e them un` ashtu kot,
se çdo gjë ka në këtë` jetë,
„Ti nga miku m`ruaj o Zot,
nga armiku ruhem vetë“.

19.04.2006 Neuhausen

Shqipëri…

Shqipëri, nënë e trazuar,
nëpër shekuj, t`kanë kënduar,
nënë e shenjtë të kan` pagëzuar,
po më shumë ç`të kanë dhuruar!?

Të gjith` bijtë, s`i kishe n`gji,
se mes trupit kish kufi,
ca n`Kosovë, ca n`Iliridë,
ca n`Preshevë, e ca n`malsi.

Çamërinë s`e kem haruar,
gur e dru të përvëluar,
pleq e plaka e fëmijë,
nëpër pragje masakruar.

Oj nën` Shqipëri,
duro dhe pak,
po vjen dita,
të jemi bashkë,

Edhe vuajtjes shekullore,
do t`i vëmë njëherë kapak.

13.04.2006 Neuhausen

Kërkesat...

Dikush kërkon krahë
që të fluturojë,
i varfëri bukë,
që të mbijetojë,
i pasuri, kamjen
kërkon
që ta mbrojë,
i poshtri, veset
si vlerë do t`i shtojë.
në kanxhat e k`saj bote,
gjithkush diç` kërkon,
unë...
dua veç zemrën
nga kjo botë ta mbroj.

12.04.2006 Neuhausen

Njeriu dhe koha

Që nga e kaluara,
për të gjitha hallet,
shkurt e troç i themi,
„Koha i ka fajet”.

Kur shkon për vizitë,
miku s`lëviz vendit,
se i shkon n`atë kohë
kur i prishet rendi.

N`kafene me shokë,
t`ngarkon epitete,
vazhdon, por dhe shton,
në shtëpi kur vete.

10.04.2006 Neuhausen

Rrugë pa-rrugë

S`të thashë rri
kur ti shkove,
lirinë the: e dua
në rrugën që zgjodhe.

S`pyete,
as tregove,
pa thuaj a e gjete
ate që kërkove?

Këtu çdo gjë kishe,
lirinë,
qetësinë,
po une s`e di a i meritove!?

09.04.2006 Neuhausen

Duarzbrazur

Duarzbrazur linda,
duarzbrazur mbeç,
duarzbrazur vdekjen
heshtas po e pres...

25.01.2007 Neuhausen

Ego...

Unë dhe ai,

po!

e imja dhe e tija,

po!

për mua dhe për te,

po!

ku je ti!?

29.03.2006 Neuhausen

Shtëpia ime

Në çarshi të epër,
pran` lumit Shkumbin,
afër një mulliri,
e kisha shtëpinë.

Fëmininë time,
aty e jetova,
dhe klasën e parë,
aty e fillova.

Sa shumë përjetime,
mbetën në at` vend,
sot e kësaj dite,
unë i kam ndërmend.

Në vitet që shkuan
ç`do gjë ishte tretur,
në fole kujtimesh
asgjë s`kishte mbetur.

Sikur s`kish fëmijë,
gjith` ishin të rritur,
s`loznin si dikur,
po rrinin t`mërzitur.

Lojrat popullore
s`ishin si atëherë,
ishin zëvendësuar,
me lojra - fliper.

Drejtova shikimin
pash një tjetër kulm,
nuk ish` më shtëpia,
ku u rrita unë.

Ishte më e madhe,
edhe më e bukur,
por edhe kujtimet
diku ishin zhdukur.

Ktheva sytë nga mali,
që ish` pran shtëpisë,
doja t`i kujtoja,
ditët e fëminisë.

Ato ditë pranvere,
kur mali gjelbëronte,
e në degë t`bagremit
bilbili këndonte.

Nga shtrati, pranë malit,
ndahej një përua,
prej lumit Shkumbin
me ujë të kulluar.

Kishte shumë ndryshime,
- s`loznin më fëmijë,
- natyra e qielltë
ish` bërë deponi.

Më theri një dhimbje
shpirtit tim të dlirë,
e klitha nga dhimbja!
„Njerëz pa mëshirë“.

S`kishte as rrugicë
për n`brendi të pyllit,
s`shkonte as përoi
në drejtim t`mullirit.

Gjithë ato ndodhi
ishin përjetime,
tani më janë bërë
pjesë e dhimbjes sime.

27.03.2006 Neuhausen

Lindja

Atje ku lind dielli,
lindi qënja jonë,
e bekoi qielli
të na ndrij gjithmonë...

20.03.2006 Neuhausen

Paradoks

njëherë thonë,
ke të drejtë.
pastaj thonë,
s`ke të drejtë.

ke të drejtë,
s`ke të drejtë
me dhe pa
të ik kjo jetë.

16.03.2006 Neuhausen

Jeta

Shenjë e parë e jetës
është një frymëmarrje,
shenjë e dytë e saj
eshtë një frymëdalje…

Një fill ka përherë
që askush s`e di,
ku mbaron një rrugë,
ku nis përsëri.

Beson a s`beson
është punë për ty,
të gjitha këto
veç një Zot i di!

12.03.2006 Neuhausen

Drita e hënës

Nëna për ty jetova,
dhimbje e mall për ty durova,
ëndrra e gjumë e buzëqeshje,
pa asnjë kusht ty ti dorëzova.

Shijo jetën or bir i nënës,
dhe nëse shija i mungon
dhe hidhi sytë nga drita e hënës
ku sytë e mi përnatë t`kërkojnë.

07.11.2006 Neuhausen

Fjalë e lënë

Erdhi dita që u pamë,
folëm, qeshëm edhe qamë,
po nga malli asgjë s`thamë,
mbase peng një fjalë e lamë.

Mbase peng një fjalë mbeti,
e s`do thuhet asnjëherë,
është mall e vaj gurbeti,
është jetë pa pranverë...

15.01.2007 Neuhausen

O njeri!

O njeri!
qënie e përsosur,
kurrë më poshtë se sot s`ke rënë!
nder e rracë ta kanë njollosur,
trup e shpirt t`i mbajnë nën këmbë!
zgjohu ec e mos u ndal,
kërko hisen qe s`ta dhanë,
shtrëngo grusht e mbath opingat,
mos përfill më sharllatanë...
O njeri!
qënie e përsosur,
k`theju vetes n`dashuri,
falja fajet atij tjetrit,
të të falë Zoti ty…

12.06.2006 Neuhausen

Natyra

S`është siç ka qenë natyra,
tjera hire dikur kishte,
nuk e ka më shenjtërinë,
s`është e virgjër më siç ishte...

08.06.2006 Neuhausen

Vaji i mbesës

Dhjet vite kaluan,
                    që kur ike ti,
Atje prapa qiejsh
                    në përjetësi.

Ike si një hije
                jetën pa shijuar!
Dajë-Bujar i zemrës
                o mall i pashuar...

Do të qaj me ligje
                mbesa yte Florë,
gjersa të t`vi pranë,
                daj` s`do të harroj.

30.05.2006 Neuhausen

Një udhë kemi përpara...

Krijesa të Zotit jemi,
në shumë fe edhe besime,
të gjithë një udhë kemi,
për tek Zoti që na shpie.

Gjith` një Shpirt, një zemër kemi,
rracë e ngjyrë s`janë për tjetër,
që të njihemi më mirë,
na thotë Zoti i vërtetë...

26.05.2006 Neuhausen

Ndjenje e fëminisë

Vëllezër, motra, fëmijë tjerë,
rriten bashkë në një oborr,
çdo gjë e asgjë s`ka vlerë,
fill i jetës kështu fillon.

Ç`ish me vlerë e ç`ish pa vlerë,
koha ik vetëm një herë,
kur fëmi s`bëhesh dy herë,
qeni vlerën ta përmjerë...

25.05.2006 Neuhausen

Faqebardhë

Durim jepi Zot,
E ndjenjë t`kulluar,
Fuqinë ktheja Zot,
Shpirtit të lënduar.

23.05.2006 Neuhausen

Mbështetje e gabuar

Shumë vetë të mbështetën,
e neve na shanë,
t`kanë thënë s`të duam,
në rrugë t`kemi lënë.

Ndoshta u besove,
këtë s`ta kemi thënë,
shihe pra tani,
cilin e ke pranë!?

Dikush po na pyet!?
si je me shëndet!
themi se je mirë,
dhe mirë qofsh për jetë.

Humbe rrugën bir,
more tatëpjenë,
ashtu siç humb qingji,
kur e le kopenë.

Ndonjëherë të them,
edhe këtë dua,
ndoshta edukata,
ka qen` e gabuar!

Pra, edhe mbështetjen,
që ta kanë ofruar,
është një truk tjetër,
që të ka mashtruar.

Ka edhe të tillë,
fare nuk dyshoj,
fëmijëve pa prindër,
strehër u ofrojnë.

Ju që prindër keni,
duhet ti nderoni,
se në strehë të huaj
gjatë s`mund t`qëndroni.

Se të le në rrugë,
këtë s`e kupton,
mos e ha me lugë,
turpin se e gabon.

Por edhe gabimet,
e kan` një kufi,
të merret e drejta,
të jetosh n`liri.

Po vazhdojnë mërzitë,
që nuk kan mbarim,
ne e kem` kuptuar, se
jeta është provim.

Tek ne është e njejtë,
ndjenj` e dashurisë,
pa ty është e rëndë,
rrugë e pleqërisë.

05.05.2006 Neuhausen

Kënga e mëngjezit

Sa i bukur është mëngjezi,
çdo gjë ngjallet përsëri,
në çati këndon këndezi,
loz fëmija në avlli.

Lulëzojn` lulet n`rreze dielli,
n`harmoni të kompozuar,
dallëndyshja lart nga qielli,
na thot: vera është afruar.

Në mëngjez çdo gjë fillon,
pun` e mbarë edhe me vlerë,
zgjohuni e merni udhët,
faqebardhë dhe me nder.

30.04.2006 Neuhausen

Vdekja

Të jap dorën miku im,
të jap dorën pa ngurrim,
jam njeri që kam besim,
ndaj të pres në përqafim.

Vdekja duhet merituar,
por njëherë duhesh sprovuar,
ja pra dorën po ta shtroj,
që në paqe unë të shkoj...

13.04.2006 Neuhausen

Ndjenjë...

Një ndjenjë të shenjtë,
seç kërkon kjo jetë,
dhe pak dashuri,
që jetë të ketë!

24.03.2006 Neuhausen

Biografia ime...

Ka qenë ditë nëntori
kur në dritë kam ardhë,
në zemrën e nënës
isha yll i parë.

Më thanë të mësoj
për udhët e jetës,
më thanë t`i falem
pas Zotit dhe shpresës...

Më thanë t`i falem
dhe dijes dhe djersës,
më thanë t`i falem
dhe nderit dhe besës...

13.05.2008 Neuhausen

Për babin tim

Mami, mami më dëgjon?
unë e di që ti më do,
më ke xhan e më ke Shpirt,
n`sytë e tu un` jam një dritë.

Jam një dritë e paanë,
jam një yll që n`tokë ndriçon,
jam Learti djal i mbarë,
jam një engjëll që të mbron.

Unë të mbroj se kam nevojë,
për kujdes dhe edukim,
përralla, vjersha të mësoj,
që t`ia them unë babit tim.

10.12.2007 Neuhausen

Kaderi në jetë

Këtë dit` të shenjtë s`e ndaj me askend,
nuk dua ta shkruaj në asnjë ditar,
nuk ka me se shkruhet shpirti kur të dhemb,
më nirë le të fshihet me mua nën varr...

Është ditë e vitit të tretë në jetë,
ditë e stërzgjatur m`e rëndë se kurrë,
nipi diku rritet, diku qan e qeshë,
diku qaj e qesh nën vete dhe unë...

Akoma s`i ndjeva erën në lëkurë,
erën e tim gjaku kur do ta shijoj,
kaderi i jetës zemrën po ma shkul,
më jep sabër Zot sprovën ta kaloj...

28.08.2007 Neuhausen

Engjulli im me fletë...

Dua një këngë të këndoj,
një këngë të pakënduar,
dua kënga të gjëmojë,
e mos ketë të mbaruar.

Një këngë për ditëlindje,
që i mbushe trembëdhjetë,
shpejt më ikën këto vite,
që më mbajtën gjallë në jetë.

Rrofsh e qofsh njëqindenjë,
lumturi të kesh në jetë,
të kam këngën më të bukur,
të kam engjull me shumë fletë.

21.07.2007 Neuhausen

Në pleqëri i ri

S`ka njeri që s`do,
t`arrij në pleqëri,
por rrallë kush mendon,
gjer sa është i ri.

Edhe unë dua,
t`arrij në pleqëri,
të jem plak me rrudha,
e të mbes njeri.

22.05.2007 Neuhausen

Më një qershor

O fëmij` të botës mbarë,
ju o engjuj shpirtkristal,
thonia këngëve qiellore,
jepni botës një mesazh...

O fëmij` të tokës sime,
o ju engjuj shqipëtar,
o ju këngë e këngës sime,
jam e mbeç` me ju krenar...

01.06.2007 Neuhausen

Të gjithë të Zotit jemi

Veç një gjë dua në jetë,
siç do Zoti i vërtetë,
mos ket` mall e mos ket` lotë,
mos ket` dhimbje më kjo botë...

Të gjithë të Zotit jemi,
të gjithë të njejtë jemi,
Zoti vet më tha Njeri,
s`tha i bardhë as i zi...

07.05.2007 Neuhausen

Përmbajtja:

Në vend të parathënies 5
1 Një rreze 11
2 Dua… 12
3 Bilbilit 13
4 Vdekja e tim eti 14
5 Vdekja e nënës 15
6 Çegranit tim 16
7 Shtatorja e Skënderbeut 18
8 Mos u zemëro 19
9 Atë vend me pluhur... 20
10 Shpirti i vrarë 21
11 Kod` i jetës 22
12 Hipokrizi... 23
13 Edhe njëherë si dikurë 24

14 Lot i syrit 25
15 Pagjumësia 26
16 Çudia njerëzore 27
17 Ç`do gjë është e kotë 28
18 Shokut tim... 29
19 Dialog me veten 30
20 Labirinth 31
21 Në lamshin e kohës 32
22 Kënga e heshtjes 33
23 Më thuaj... 34
24 Vajza e ambël 35
25 Liria ime 36
26 Gjumi 37
27 Nëntori 38
28 E di mirë s`e diku pret 39
29 Rrugë 40
30 Vetëm një dëshirë 41
31 Civilizimi 42
32 Këndo një këngë 43

33 Malësorja e Sharrit 44
34 Instikti 45
35 Nganjëherë! 46
36 E qeshur e thyer 47
37 Kur ti flet 48
38 Ndoshta… 49
39 Kujt i duhem sot 50
40 Sot e njëqindvjet 51
41 Pa titull 52
42 Të qesh a të qajë 53
43 E drejta e ime 54
44 „I marri” 55
45 Ligji i Perëndisë 56
46 Monolog i kohës 57
47 Mund 58
48 Rrënjët e kombit 59
49 U pafshim për të mirë 60
50 A je gjallë 61
51 Monotonia 62

52 Të lutem 63
53 Kalimtar i rastir 64
54 Oda e burrave 65
55 „Sedra” 66
56 I ligu 67
57 Të thënat 68
58 Pa-kujdesia! 69
59 Jetëkalimi 70
60 Vullneti i lirë 71
61 Lules së tharë 72
62 Pasqyr-fytyra 73
63 Mall nëne 74
64 Bota e çudirave 75
65...kuptim... 76
66 Shumë fjalë 77
67 Dituria 78
68 Bukuria djallëzore 79
69 9 Maji 80
70 Brenga e kohës 81

71 Jeta është një harmoni 82
72 Kufijtë e jetës 83
73 Rrofshi qofshi sharll 84
74 Sinqeriteti 85
75 Pendimi 86
76 Mosha e pleqërisë 87
77 Fytyr e dyfisht 88
78 Shqipëri… 90
79 Kërkesat... 91
80 Njeriu dhe koha 92
81 Rrugë pa-rrugë 93
82 Duarzbrazur 94
83 Ego 95
84 Shtëpia ime 100
85 Lindja 101
86 Paradoks 102
87 Jeta 103
88 Drita e hënës 104
89 Fjalë e lënë 105

90 O njeri! 106
91 Natyra 107
92 Vaji i mbesës 108
93 Të Zotit jemi 109
94 Ndjenja e fëmini 110
95 Faqebardhë 111
96 Mbështetje e gabuar 115
97 Kënga e mëngje 116
98 Vdekja 117
99 Ndjenjë 118
100 Biografia ime 119
101 Për babin tim 120
102 Kaderi në jetë 121
103 Engjulli im me fletë 122
104 Në pleqëri i ri 123
105 Më një qershor 124
106 Të gjithë të Zotit jemi 125
Përmbajtja: 127
Në vend të prapathënies 133

Në vend të prapathënies

Nuk kam ç`të them më shumë për librin; e keni në dorë, lexoni dhe thoni ç`keni për të thënë, qoftë përpara syve, qoftë edhe pas krahësh. Disa herë u kam dhënë leje, herë përmes vargjesh, herë përmes udhës që kam bërë në jetë. Dua të them diçka më tepër, diçka që ngjizi vargum tim. Nuk e di a do gjeja forcë, mes gjithë atyre andrallash që më ranë si përbindësha mbi kokë, po t`mos ish një dorë pranë meje, një dorë që më fshinte djersët; po t`mos ish një shpirt pranë meje që shpirtit shpirt m`i jepte.

Do kishte mbetur mbase diku, thellë në mendjen time, mbase dhe shpirti do ta mbante se ishte zjarr i tij, po kur në letër s`do të zbriste vargu i shpirtit tim. Nga dora që më fshinte ballë, dhe shpirti që më jepte shpirt, dhe zemra që më jepte zemër më dha dhe frymë nga frymë e saj që unë përpara jush të dal:

Këto vargje i shkulëm bashkë
nga dhimbje e shpirtit tonë
të përgëzoj më duket pak
o jeta ime Florë...

Neuhausen: 2007

Këtë libër ua dedikoj prindërve të mi, të ndjerë, që më edukuan në rrugën e drejtë të kësaj jete:

Më thanë të mësoj,
për udhët e jetës,
më thanë t'i falem,
pas Zotit dhe shpresës...

Më thanë ti falem,
dhe dijes dhe djersës,
më thanë ti falem,
dhe nderit dhe besës...

Kadri Alit Sherifi

Kadri Alit Sherifi
Lindur në Çegran më 01.11.1954